

Rezultatet e projektit

01 PËRMIRËSIMI I KOORDINIMIT NDËRSEKTORAL

nëpërmjet përforsimit të punës së organeve koordinuese përgjegjëse për zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e Konventës së Stambollit.

02 PËRGJIGJJA E DUHUR NDAJ RASTEVE KONKRETE

nëpërmjet rritjes së aftësive njerëzore (*soft skills*) dhe profesionale (*hard skills*) që u nevojiten punonjësve të autoriteteve ligjzbatuese për t'iu përgjigjur rasteve konkrete në mënyrën e duhur dhe efektive.

03 SHMANGIA E RI-VIKTIMIZIMIT

nëpërmjet rritjes së ndërgjegjësimit të ofruesve të shërbimeve mbi stereotipet, paragjykimet, shkaqet, shenjat dhe efektet e DhBGj-së.

04 RITJA E RAPORTIMIT TË RASTEVE

duke bërë që publiku i gjerë dhe grupet vulnerabël t'i kuptojnë më mirë të gjitha format e DhBGj-së dhe shërbimet e dedikuara të ofruara.

Partnerët


Projekti zbatohet në bashkërendim me Këshillin e Evropës, Agjencitë e OKB-së, ODIHR-in, Programin e OSBE-së për Çështjet Gjinore dhe misionet e OSBE-së në vendet ku ato operojnë. Ai kontribuon në Objektivin e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZhQ) 5 dhe 16.



Për më shumë mbi Projektin vizitoni www.osce.org/JusticeInCombatingGBVInSEE ose ndiqni ndërvëprimin tonë në mediat sociale në [#JusticeNoGBVInSEE](https://twitter.com/JusticeNoGBVInSEE)

Follow OSCE



 OSCE Secretariat
Wallnerstrasse 6
1010 Vienna, Austria

E-mail: Alina.Munteanu@osce.org
BjornTore.Saltvik@osce.org
www.osce.org/JusticeInCombatingGBVInSEE

 Organization for Security and Co-operation in Europe



DREJTËSIA NË LUFTË NDAJ DHUNËS ME BAZË GJINORE
në Evropën Juglindore

Rritja e kapaciteteve të drejtësisë penale për të luftuar dhunën me bazë gjinore në Evropën Juglindore

[#JusticeNoGBVInSEE](https://twitter.com/JusticeNoGBVInSEE)

 Organization for Security and Co-operation in Europe

Një qasje gjithëpërfshirëse rezulton në një përgjigje gjithëpërfshirëse ndaj DhBGj-së

Projekti “Drejtësia në Luftë ndaj Dhunës me Bazë Gjinore në Evropën Juglindore” synon të rrisë efektivitetin e punonjësve të sektorit të drejtësisë penale (veçanërisht punonjësve të policisë, hetuesve dhe prokurorëve) për t’iu përgjigjur rasteve të dhunës me bazë gjinore (DhBGj), duke treguar një qasje të koordinuar dhe të përqendruar tek i/e mbijetuari/a. Gjithashtu, projekti synon rritjen e ndërgjegjësimit tek punonjësit e sektorit të drejtësisë penale dhe tek publiku i gjerë për stereotipet e paragjykimet gjinore, shkaqet, shenjat, sinjalet dhe efektet e DhBGj-së, duke kontribuar kështu në ndryshimin organizativ dhe ndryshimin e kulturës.

Nëpërmjet angazhimit të të gjithë aktorëve (punonjësve të autoriteteve ligjzbatuese dhe të drejtësisë, shërbimeve sociale, organizatave të shoqërisë civile) si dhe nëpërmjet bashkërendimit të punës me institucionet e kujdesit shëndetësor dhe arsimor, projekti siguron një qasje gjithëpërfshirëse e cila rezulton edhe në një përgjigje gjithëpërfshirëse ndaj DhBGj-së.



Projekti synon forcimin e kapaciteteve të punonjësve të sektorit të drejtësisë penale për të parandaluar dhe për t’iu përgjigjur dhunës me bazë gjinore, duke kontribuar në fund të fundit edhe në rritjen e besimit të publikut tek mekanizmat e raportimit.

Konteksti

DhBGj-ja është një nga shkeljet më serioze dhe më të përhapura të të drejtave të njeriut që jo vetëm që ndikon në sigurinë dhe mbrojtjen e viktimave, por gjithashtu kufizon liritë e tyre dhe pengon zhvillimin e tyre të plotë

individual e shoqëror. Të gjitha format e DhBGj-së sjellin vuajtje afatgjatë për të mbijetuarit/at dhe familjet e tyre, përfshirë këtu traumat fizike dhe psikologjike.

Në Evropën Juglindore, DhBGj-ja mbetet një sfidë. Një përqindje e madhe e grave në rajon mendojnë se dhuna është “e zakonshme/mjaft e zakonshme”; se gratë nuk e raportojnë pjesën më të madhe të incidenteve në polici dhe se ato rrallë kërkojnë mbështetje pranë institucioneve të tjera; dhe se ato nuk i përfitojnë në mënyrë të vazhdueshme shërbimet e ofruara, për shkak të mungesës së besimit tek organet e drejtësisë.

Kriza e COVID-19 ka përqendruar nivelet e DhBGj-së. Faktorë të tillë si: detyrimi për të qëndruar në izolim me abuzuesin, humbja e mundshme e vendit të punës, nivele më të larta stresi dhe konsum alkooli ndikojnë në dinamikat e dhunës, duke u mbivendosur edhe me shkaqet e rrënjësura thellë të dhunës siç janë marrëdhëniet e pabarabarta të pushtetit apo normat dhe sjelljet e dëmshme shoqërore.



Koordinimi ndër-sektorial:

5 komisione kombëtare ndër-institucionale

Trajnim multidisiplinor:

1 kurrikulë trajnimi rajonale dhe bashkëkohore

5 kurrikula kombëtare të përditësuara

1 kurs rajonal për trajnimin e trajnerëve

5 kurse kombëtare trajnimi të specializuara

Rritje ndërgjegjësimi:



Materiale sensibilizuese për organet e zbatimit të ligjit dhe gjyqësorin



Materiale sensibilizuese për publikun e gjerë



Seminare mbi aspektin e punës së policisë dhe medias



Video-trajnime për punonjësit e organeve ligjzbatuese mbi krimet e lidhura me DhBGj-së



Trajnim për punonjësit e nivelit të parë drejtues pranë organeve ligjzbatuese